

Njoftim,

Bazuar në faktin se gjendja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike është përmirësuar, për shkak të uljes së kërkesës për energji elektrike, operimit të gjenerimit stabil brenda kushteve të operimit të termocentraleve dhe centraleve tjera në sistem, ndërhyrjes së Qeverisë për uljen e tarifave për konsumatorët e rregulluar, Qeveria ka vendosur që të mos kërkojë vazhdimin e masave emergjente në furnizimin me energji elektrike.

Pavarësisht kësaj, Qeveria dhe entitetet përgjegjëse që operojnë në sektorin e energjisë do ta përcjellin gjendjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike me kujdes të fokusuar.

Falënderojmë të gjithë për bashkëpunimin, duke shprehur njëkohësisht vullnetin dhe përkushtimin tonë për të qenë sa më afër konsumatorit të energjisë elektrike në lehtësimin e barrës së krizës globale të energjisë.